



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 15.10.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Milva Ekonomi – nënkryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të datave 9 dhe 10 tetor 2018.
2. Seancë dëgjimore me përfaqësues të shoqërisë civile për gjetjet e raportit “Mbrotjtja e fëmijëve nga dhuna dhe bulizmi në arsimin publik parauniversitar në Shqipëri”.

Marrin pjesë:

Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Almira Xhembulla, Adelina Rista, Fadil Nasufi, Ismet Beqiraj, Bujar Çela, Ilir Beqaj (deputet zëvendësues), Besnik Baraj (deputet zëvendësues) dhe Anduel Xhindi (deputet zëvendësues).

Mungojnë:

Albana Vokshi, Luçiano Boçi, Luan Baçi, Romeo Gurakuqi, Valentina Duka, Shezai Rrokaj, Nora Malaj, Kejdi Mehmetaj, Musa Ulqini, Fatmir Velaj, Vilma Bello.

Të ftuar:

Linda Pino – koordinatorë e Koalicionit për Arsimin në Shqipëri,
Mirgit Vataj – drejtor ekzekutiv i Linjës Kombëtare të Telefonit për Fëmijët në Shqipëri “Alo 116”,
Altin Hazizaj – drejtor i Përgjithshëm i Qendrës për Mbrotjtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri (CRCA),
Shqiponja Lamçe – specialiste e Drejtorisë së Arsimit Parauniversitar në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

HAPET MBLEDHJA

Milva Ekonomi – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Sot kemi mbledhjen e radhës të komisionit, i cili ka në rend dite një seancë dëgjimore me përfaqësuesit e shoqërisë civile rreth gjetjeve të raportit “Mbrotja e fëmijëve nga dhuna dhe bulizmi në arsimin publik parauniversitar në Shqipëri”.

Prezent në këtë mbledhje kemi zonjën Linda Pino, e cila përfaqëson Koalicionin për Arsimin në Shqipëri; zotin Mirgjit Vataj, drejtor ekzekutiv i shërbimit “Alo 116”; zotin Altin Hazizaj, drejtor i Përgjithshëm i CRCA-së, i cili gjithashtu do të flasë rreth gjetjeve të raportit dhe për disa problematika të lindura në organizatën e tij, si dhe zonjën Shqiponja Lamçe, Specialiste e Drejtorisë së Arsimit Parauniversitar në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Përpara se të fillojmë me ju, dua t’ia jap fjalën zotit Fidel Ylli, lidhur me plotësimin ose jo të kuorumit për të zhvilluar këtë mbledhje.

Fidel Ylli – Kuorumi është i plotë, prezentë jemi dhjetë anëtarë, kështu që mbledhja mund të vazhdojë, por unë përsëri ndiej keqardhje për opozitën, e cila ka kohë që flet për dhunën në familje, dhunën kundër grave dhe fëmijëve, ndërkohë kur vjen momenti për debat dhe dëgjuesë me shoqërinë civile për sa i përket problematikës së dhunës, përsëri nuk vjen.

Megjithatë, ne do të vazhdojmë punën tonë.

Milva Ekonomi – Faleminderit, zoti Ylli!

Në fakt, dua t’ia jap fjalën fillimisht edhe zotit Fadil Nasufi, i cili do të adresojë një mesazh urimi.

Fadil Nasufi – Faleminderit, zonja nënkryetare!

Sot universitetet shqiptare hapin dyert për fillimin e vitit të ri akademik, ndaj me këtë rast urojmë, si komision, të gjithë studentët dhe pedagogët për një vit akademik të mbarë dhe të suksesshëm në përmbushjen e reformës që kemi për arsimin e lartë, si dhe në përmbushjen e të gjitha detyrimeve që kemi për forcimin dhe konsolidimin e shkollës, e cila në këto vite dhe në këtë arsim po njeh një hov të ri cilësor, në përmbushje të misionit që ka arsimi i lartë në Shqipëri!

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Faleminderit, zoti Nasufi!

Po ua kaloj fjalën përfaqësuesve të shoqërisë civile për të na njohur me gjetjet e raportit. Paraprakisht dua t'ju them se të gjithë e kemi marrë raportin tuaj, dërguar pranë sekretarisë së komisionit, e cila bëri të mundur jo vetëm shpërndarjen e tij elektronikisht tek të gjithë anëtarët e komisionit, por edhe printimin në *hard copy*. Pra, ne jemi njohur paraprakisht me raportin tuaj.

Gjithashtu, dua ta falënderoj zonjën Linda, e cila e kërkoi këtë dëgjese në një mbledhje...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Edhe zotin Altin, patjetër, por zonja Linda mori autorësinë për këtë çështje në një dëgjese të Nënkomitetit për Dhunën në Familje dhe ku adresonim disa çështje të rëndësishme, që duhet të kishin zgjidhje në legjislacion.

Shumë faleminderit!

Fjala është për ju, zonja Pino.

Linda Pino – Faleminderit për pritjen dhe që bëtë të mundur realizimin e kësaj dëgjese, për sa u përket disa prej gjetjeve të raportit që ne nuk e kemi bërë ende publik, pasi ka nevojë për disa redaktime përfundimtare për sa u përket aspekteve gjuhësore, por që prek një çështje tejet të rëndësishme, e cila duhet adresuar si pranë komisionit tuaj, ashtu edhe në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë në lidhje me dhunën në institucionet arsimore.

Ne, si shoqëri civile, i shohim shpesh nga televizioni rastet e dhunës që ushtrohet ndaj nxënësve në institucionet arsimore. Po ashtu, ka edhe shumë studime, të cilat janë bërë nga organizatat në Shqipëri, siç kemi këtu Linjën kombëtare të Këshillimit për Fëmijë “Alo 116”, e cila gjithashtu mirëpret dhe trajton rastet e dhunës në institucionet arsimore.

Por përse ndërmorëm ne të bënim një vëzhgim lidhur me dhunën në shkolla? Nisur nga disa dhëna, duke parë që prej vitit 2013 një studim, i cili kishte të bënte me dhunën në Ballkanin Perëndimor, BECAN, ka evidentuar se fëmijët e përfshirë në studim, në 69% të rasteve kanë përjetuar dhunë psikologjike, 59% e tyre kanë përjetuar dhunë fizike, ndërsa 11% kanë raportuar dhunë seksuale.

Programi “Kombi” i vitit 2016 ka evidentuar se 41% e fëmijëve ose 1 në 3 nxënës në Shqipëri raportojnë përjetim të formës së dhunës psikologjike.

Studimi i Këshillit të Europës ka evidentuar se 19,4% e fëmijëve janë të përfshirë në fenomenin e bulizmit dy-tri herë në muaj, rreth 73% e nxënësve janë viktimë dhe parapëlqejnë që ta raportojnë bulizmin kur ndodh, ndërsa 27% e tyre nuk kanë parapëlqyer që ta tregojnë atë. Ndërkohë, mësuesit e pyetur në studimin e Këshillit të Europës kanë evidentuar faktin se

dëshirojnë të kenë brenda institucionit të tyre një mekanizëm, ku fëmijët të raportojnë momentin e dhunës apo të bulizmit kur ai ka ndodhur.

Gjithashtu, Shqipëria ka firmosur në nivel ndërkombëtar axhendën e zhvillimit të qëndrueshëm, ku objektivi nr. 16, pika 2, i zhvillimit të qëndrueshëm thotë shprehimisht: “Çdo shtet duhet të marrë masa që brenda vitit 2030 të eliminojë çdo formë dhune që shkaktohet ndaj fëmijëve”.

Ne kemi parë edhe strategjinë ndër vite të arsimit parauniversitar 2014-2020, e cila ka vendosur disa përparësi, por nga ajo që kemi vënë re ne, si shoqëri civile, është se në asnjë pikë të saj nuk flitet për masat që duhet të marrë ministria për parandalimin, raportimin apo trajtimin e dhunës. Strategjia flet për përsosje të qeverisjes, të udhëheqjes dhe menaxhimit të kapaciteteve dhe të burimeve, nxënie gjithëpërfshirëse dhe cilësore, sigurimin e cilësisë, bazuar në standarde të krahasueshme me vendet e BE-së, përgatitje dhe zhvillim bashkëkohor profesional të mësuesve. Nëse shihni edhe ju strategjinë, e cila është deri në vitin 2020, lind pikëpyetja: si mbrohen fëmijët nga dhuna në këtë strategji?

Gjithashtu, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar ligjin “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”. Neni 18, pika 3, germa “g”, e detyron ministrinë përgjegjëse për arsimin të ngrejë mekanizmat efikase për parandalimin, trajtimin brenda shkollës dhe raportimin tek autoritetet përgjegjëse të situatave të dhunës, duke përfshirë këtu edhe bulizmin.

A është ngritur ky mekanizëm? Mund të thuhet se hallka e parë është psikologu, por në një vëzhgim që ne kemi bërë, në bashkëpunim me linjën e këshillimit të fëmijëve, vihet re se ndonjëherë psikologu nuk njihet mirë nga nxënësit. Kemi zhvilluar orë ndërgjegjësuere me fëmijët në disa shkolla për sa i përket të drejtës për arsim dhe te pyetjet që kemi bërë, nëse ka ardhur psikologu, disa prej tyre thonë se ende nuk e njohin atë, ndërsa disa të tjerë thonë se e kanë parë, por sa ka ardhur për të bërë prezantimin. Pra, ajo që duhet është një fuqizim sa më i madh i rolit të psikologut.

Në vitin 2015-2016 Ministria e Arsimit hartoi një plan mbarëkombëtar, i cili kishte të bënte me eliminimin e dhunës në institucionet arsimore. Edhe ne, si shoqëri civile, u bëmë pjesë e këtij plani kombëtar, por na lindi pyetja: a u hartua një raport për sa u përket gjetjeve që dolën nga pjesëmarrja e të gjithë aktorëve? Pra, a u ndërgjegjësuam fëmijët? A e kreu misionin kjo strategji apo ky plan kombëtar që ndërmori Ministria e Arsimit?

Për vite me radhë, edhe vitin e kaluar, është bërë rishikimi i ligjit për arsimin parauniversitar publik. Ne, si koalicion, e kemi ngritur shpeshherë çështjen e rishikimit të ligjit për sa i përket dhunës në institucionet arsimore dhe kemi depozituar pranë Komisionit

për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, por edhe pranë Ministrisë së Arsimit, ndërhyrjet që ne, si shoqëri civile, sepse ato kërkojnë një këndvështrim më të gjerë për sa u përket aspekteve juridike, të ndryshimit të ligjit për arsimin parauniversitar në dy aspekte, të cilat ne i konsiderojmë tepër të rëndësishme, që kanë të bëjnë me shërbimin psiko-social në institucionet arsimore, të cilat në këndvështrimin tonë, ne duhet të kemi në nivel kombëtar një shërbim kombëtar psiko-social, të vendosur pranë çdo shkolle dhe një rishikim të komisionit të etikës në institucionin arsimor. Komisioni i etikës në shumicën e rasteve merret kryesisht me figurën e mësuesit, me përmbushjet e detyrave të mësuesit.

Por kush e trajton fëmijën në shkollë? Kush e parandalon dhunën në shkollë? Ku drejtohet fëmija në momentin kur ka ndodhur një rast dhune? Ndonjëherë, edhe vetë mësuesit, edhe nxënësit kanë nevojë të këshillohen me psikologun për sa u përket rasteve të dhunës. A e kanë ata të hapur derën e psikologut nëpër shkollë?

Normalisht do të ishte ideale që përgjigja të ishte po, por ajo që vihet re është që numri i psikologëve, të cilët lëvizin nga njëra shkollë në tjetrën, e bën të pamundur që të ketë një psikolog në momentin kur ka ndodhur dhuna.

Për ta përmyllur, komisioni i etikës dhe i sjelljes në institucionin arsimor, për të bërë të mundur që të ketë një këndvështrim më të gjerë për sa i përket aspektit të dhunës, për mendimin tonë, duhet të jetë një komision për parandalim e dhunës dhe zbatimin e rregullores në institucionet arsimore, që të jetë një derë ku fëmija të shkojë.

Në komisionin e etikës dihet që është i pranishëm edhe psikologu, por një qasje më e gjerë e kësaj figure do të ishte fuqizimi i figurës së psikologut brenda shkollës, që ai të jetë avokati i fëmijëve brenda shkollës dhe jo të jetë mësuesi kujdestar apo drejtori i shkollës, dhe një herë psikologu dhe fëmija nuk e ka pikën e tij udhëzuese apo yllin e tij polar, ku duhet të drejtohet, kur ka një problem.

Faleminderit!

Fidel Ylli – Unë mendoj të vazhdojmë me ligjëratat e të ftuarve dhe më pas me pyetjet e kolegëve.

Mirgjit Vataj – Faleminderit, zoti Ylli!

Unë drejtoj linjën kombëtare të këshillimit për fëmijët, i cili është i vetmi mekanizëm 24 orë në shërbim të fëmijëve, çdo ditë dhe pa pagesë për të raportuar rastet e dhunës, të abuzimit të shfrytëzimit.

Në të njëjtën kohë, gjatë draftimit dhe hartimit të këtij raporti ne jemi ndalur shumë edhe te fushata që kemi zhvilluar gjatë vitit 2015-2016 dhe në vazhdim, për të parë të gjitha

gjetjet dhe për të bërë një analizë se si funksionon mekanizmi i referimit të rasteve të dhunës brenda shkollave.

Ashtu siç e përmendi edhe zonja Pino, ka pasur faktikisht një fushatë gjatë vitit 2015-2016, për t'i thënë stop dhunës në shkolla, që është iniciuar nga Ministria e Arsimit në bashkëpunim edhe me organizatat e shoqërisë civile, e cila kishte mision për të ndërgjegjësuar të gjithë aktorët kryesorë, profesionistët që punojnë në sistemin arsimor, organizatat e shoqërisë civile, komunitetin e prindërve në tërësi për të eliminuar të gjitha format e dhunës, të cilat ndodhin brenda sistemit arsimor. Ky plan veprimi ka theksuar rëndësinë e shërbimit psiko-social në shkolla, si një mekanizëm i parë i raportimit të rasteve të dhunës brenda sistemit arsimor.

Gjithashtu, i ka dhënë një rëndësi të madhe edhe çështjes së parandalimit, vlerësimit dhe trajtimit të këtyre rasteve të dhunës. Kjo ka qenë një qasje multisektoriale me të gjithë aktorët, të cilët ndikojnë sot në sistemin e arsimit.

Faktikisht, dua të ndalem pak te roli i psikologut, por dua të sjell në vëmendjen tuaj edhe rastet që janë raportuar te Linja e Këshillimit për Fëmijë nga viti 2009 deri në vitin 2016. Të gjitha rastet janë raportuar nga vetë fëmijët me iniciativën e tyre. 350 raste të raportuara ishin kryesisht raste të problemeve me mësuesit. Në të njëjtën kohë, janë edhe 502 raste që u referohen çështjeve të bulizmit dhe marrëdhënieve bashkëmoshatore.

Ne jemi ndalur për të parë rolin e psikologut dhe punonjësit socialë, pasi shërbimi në shkolla konsiderohet një shërbim psiko-social. Ne kemi vënë re se psikologët kanë si prioritet të tyre parandalimin e rasteve të dhunës dhe të abuzimit, por edhe punën me punonjësit e sistemit arsimor, prindërit, nxënësit dhe të gjithë aktorët e tjerë për eliminimin e formave të dhunës. Po në kuadër të parandalimit, profesionisti i shërbimit psiko-social të institucioneve arsimore ndërgjegjëson edhe vetë institucionin arsimor për pasojat e dhunës dhe për masat që duhet të ndërmerren për të luftuar çështjet e dhunës në shkollë.

Dy janë problematikat që kemi evidentuar në rastet e referuara pranë shërbimit social në shkolla. Pra, duke qenë se ne jemi një linjë këshillimi dhe marrim raportimet, në të njëjtën kohë kryejmë edhe procesin e referimit të këtyre raportimeve pranë shërbimeve psiko-sociale në shkolla. Nga problematikat që kemi ndeshur, na ka rezultuar që profesionistët e shërbimit psiko-social punojnë pak ose shumë pak në drejtim të përgatitjes së prindërve dhe stafëve akademike për t'u përballur me fenomenin e dhunës, abuzimit dhe bulizmit; e dyta, nuk ka një procedurë të qartë, të specifikuar që ndiqet nga psikologët dhe punonjësit socialë shkollorë në rastet e dhunës, abuzimit dhe bulizmit, duke u mbështetur në dispozitat normative të arsimit

parauniversitar, veçanërisht në nenin 46, ku përcaktohen mënyrat, format dhe procedurat e menaxhimit të rasteve të dhunës brenda sistemit arsimor nga profesionistët e shërbimit social.

Secila nga format e dhunës, më të cilat fëmijët përballen në shkollë, duhet të ketë një protokoll të specifikuar, që të çojë në ndërhyrje të integruar për secilin rast.

Aktualisht, në përshkrimin e punës së psikologëve dhe punonjësve socialë evidentohet dhe identifikohet se prioriteti i tyre është vlerësimi i nxënësve me probleme të sjelljes ose me vështirësi për të nxënë. Gjithashtu, psikologu harton dhe zbaton për këta nxënës plane individuale parandaluese ose rehabilituese. Pra, le të themi se psikologu dhe punonjësi social janë hallka e parë që përballen me rastet e dhunës dhe abuzimit në shkolla.

Edhe Komisioni i Etikës është një tjetër hallkë, e cila ka në tagrin e saj për t'u marrë me çështjet e dhunës, kryesisht me shqyrtimin e rasteve të mësuesve. Hallkë lidhëse është psikologu, i cili përgatit të gjithë dosjen përkatëse për secilin rast të referuar. Të gjitha rolet dhe funksionet e përcaktuara në udhëzimin nr.10 të vitit 2015 për institucionet e arsimit parauniversitar, janë të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me profesionistët e shërbimit psiko-social në shkolla.

U përpoqa të bëj një analizë për të treguar se cili është vërtet roli i shërbimit psiko-social në shkolla, si mekanizmi i parë i rëndësishëm, i domosdoshëm për parandalimin e dhunës, por edhe për ndërgjegjësimin për të marrë të gjitha masat e duhura për të trajnuar stafet akademike, mësuesit, por edhe prindërit në drejtim të eliminimit të dhunës në shkolla.

Në fakt, edhe në raport janë përmendur konkluzionet dhe rekomandimet tona për sa i përket shërbimit psiko-social, si një mekanizëm i rëndësishëm në parandalimin e dhunës në shkolla. Ne kemi bërë disa rekomandime, të cilat janë kryesisht për identifikimin e fëmijëve në nevojë, për mbrojtjen dhe referimin e tyre pranë njësive për mbrojtjen e fëmijëve. Pra, psikologu nuk do ta shikojë veten si një trupë të vetme në sistemin e mbrojtjes së fëmijëve, por duhet të jetë si një pjesë e integruar në sistemin e madh të mbrojtjes së fëmijëve.

Rastet e fëmijëve në rrezik.

Nëpërmjet supervizorit të njësisë së shërbimit psiko-social ose koordinatorit të psikologëve shkollorë, të gjitha rastet duhet të referohen te njësiti për mbrojtjen e fëmijëve pranë bashkive në Shqipëri. Funksionet e tjera: lehtësimi dhe mbështetja për ndjekjen e shkollës për fëmijët që janë identifikuar si fëmijë vulnerabël apo viktimë të dhunës; do të marrë pjesë në të gjitha takimet e grupeve teknike multidisiplinare dhe të mbështesë për zhvillimin dhe zbatimin e planeve individuale të hartuara për secilin fëmijë, të identifikuar si fëmijë viktimë e dhunës apo si fëmijë vulnerabël potencialisht për t'u bërë viktimë e dhunës; të punojë

në parandalimin dhe edukimin e fëmijëve për të shmangur situatat e rrezikshme dhe të sigurojë që stafi pedagogjik apo personat e punësuar në institucionet arsimore të jenë persona të sigurt për të punuar me fëmijët. Pra, të mos kenë asnjë precedent që ka të bëjë me shkeljen e të drejtave të fëmijëve.

Ne bashkëpunojmë me Ministrinë e Arsimit, të cilën gjej rastin ta falënderoj, pasi e kemi pasur një partner të mirë gjatë gjithë fushatave ndërgjegjëse që ne kemi zhvilluar në shkolla, por në të njëjtën kohë kemi pasur vullnetin për të marrë masat e nevojshme, të duhurat dhe të domosdoshme, për të eliminuar dhunën në shkolla. Ne kemi bërë edhe disa vëzhgime gjatë kësaj fushate, e cila ishte fokusuar në disa problematika.

E para, ka të bëjë me procesin e koordinimit të profesionistëve të shërbimit psiko-social me të gjithë aktorët e tjerë të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve. Sipas vëzhgimit tonë, në fokus mbetet trajtimi i rasteve ekstreme të dhunës dhe abuzimit, më pak fokus ka pasur pjesa e parandalimit. Pra, më shumë vëmendje i kushtohet pjesës së rasteve ekstreme të dhunës dhe harrohet që shpeshherë parandalimi është forma e parë për të marrë masat e duhura, për ta penguar dhe për ta eliminuar dhunën në shkolla.

Gjithashtu, një tjetër vëzhgim gjatë kësaj fushate ka të bëjë me adresimin e çështjeve të dhunës në nivele të larta të vendimmarrjes. Pra, duhet të jetë një dokumentim i mirë, i protokolluar dhe i standardizuar për të marrë gjithë informacionin e duhur, në mënyrë që të ndikojë dhe të bëjë më të mirë dhe më të efektshme pjesën e funksionimit të politikave dhe programeve, të cilat kanë të bëjnë me parandalimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës në vend.

Gjithashtu, zonja Pino u përpoq që të sillte pranë jush disa nga gjetjet që janë bërë gjatë kësaj fushate ndërgjegjëse. Faktikisht, në fund të semestrit të parë të vitit të kaluar pati një premtim nga Ministria e Arsimit për rritjen e numrit të psikologëve në shkolla dhe, me aq sa kemi informacion, numri i psikologëve në shkolla është rritur dhe mesatarisht ka shkuar një psikolog për 700-800 nxënës. Pra, çdo shkollë që ka mbi 700 nxënës do të ketë një psikolog të stacionuar apo punonjës social, që është vërtet një masë e duhur për të parandaluar dhe për të eliminuar dhunën në shkolla. Nga gjetjet që kemi bërë gjatë fushatës, kemi gjetur një psikolog për 2 mijë nxënës, çka bënte që edhe vetë fëmijët në 50% të rasteve tregonin se nuk e njihnin se kush ishte psikologu që ishte i stacionuar në shkollën e tyre. Nga bisedat që kemi zhvilluar me psikologët dhe punonjësit socialë të shkollave, na ka rezultuar që psikologët dhe punonjësit socialë nuk janë shumë të qartë për përshkrimin e punës së tyre. Pra, nuk i kanë shumë të qarta kompetencat që duhet të ushtrojnë gjatë punës së tyre të përditshme.

Gjithashtu, një tjetër gjetje shumë interesante, dhe që mendoj se ka nevojë për hulumtime të thella, është se rastet ekstreme të dhunës kur abuzuesit janë mësuesit, kanë filluar të rrallohen, por kemi kaluar në një formë tjetër dhune, kryesisht nga mësuesit, që ka të bëjë me etiketimet e nxënësve, me nofka, me epitete tepër fyese apo tepër ofenduese.

Një tjetër risi, që rrit efektivitetin e rolit të psikologëve dhe të punonjësve socialë brenda sistemit arsimor, si një mekanizëm tjetër në dorën e tyre, është ligji i ri “Për mbrojtjen e fëmijëve”. Ky ligj ka sjellë goxha risi dhe e ka bërë më të lehtë efektivitetin e të gjithë aktorëve që janë pjesë e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve, përfshirë këtu edhe rolin e psikologut dhe punonjësve socialë në shkolla. Neni 67, që i referohet detyrimit për raportim, bën që psikologu dhe punonjësi social të mos e mbajnë më rastin vetëm brenda dyerve të shkollës, por tashmë të kalojnë dhe të raportojnë tek të gjitha agjencitë, të cilat janë agjenci të rëndësishme dhe të domosdoshme për të raportuar këto raste. Specifikisht, në nenin 67 thuhet: “Çdo person fizik ose juridik, që ka informacion ose vetë fëmija, duhet të njoftojë për çdo rast të dyshuar apo të ndodhur abuzimi, neglizhimi apo shfrytëzimi të fëmijës në institucionet qendrore dhe strukturat vendore të mbrojtjes së fëmijëve ose në Policinë e Shtetit”. Pra, psikologu ose punonjësi social ka për detyrë që të raportojë çdo rast dhune të evidentuar ose në rast se bie në dijeni pranë strukturave vendore të mbrojtjes së fëmijëve ose pranë Policisë së Shtetit. Në të njëjtën kohë çdo punonjës i institucioneve publike dhe private, që vihet në kontakt me fëmijët, për shkak të profesionit dhe ka dyshim, pra këtu flasim për dyshimin kur një psikolog ose një punonjës social mund të shikojë se një fëmijë abuzohet, keqtrajtohet apo neglizhohet, patjetër duhet të njoftojë strukturat përgjegjëse në Policinë e Shtetit apo njësitë për mbrojtjen e fëmijëve. Besoj se është një mekanizëm i ri në duart e psikologëve dhe të punonjësve socialë, kësaj here detyrues, jo më në dëshirën e psikologëve dhe të punonjësve socialë për të raportuar. Këto janë disa nga gjetjet që kemi bërë gjatë fushatës, gjatë vëzhgimeve, gjatë vizitave në shkolla, gjatë bisedave me stafet akademike, por edhe me nxënësit vetë, për të parë se cilat janë hapësirat dhe mundësitë e mundshme, që ta bëjmë më të efektshme rolin e shkollës dhe të institucionit vetëarsimor, për të qenë më i efektshëm në eliminimin e dhunës në shkollë.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Faleminderit!

A ka dikush tjetër nga ju diçka për të shtuar?

Altin Hazizaj – Mirëmëngjesi të gjithëve dhe faleminderit që na keni thirrur në komision!

Në fakt, desha që ta bëja më pak interaktive të gjithë bisedën, që të hiqnim pak dorë edhe nga këto formalizmat, por edhe për ta bërë çështjen më reale. Sa nga ju kanë fëmijë vetë, që janë në moshën e arsimit parauniversitar, që do të thotë deri në fund të vitit të klasës së IX? Kemi 1. Nipër dhe mbesa që janë në klasë të I deri në klasë të IX? Në rregull kemi. Sa nga ata ankohen që janë viktimë të dhunës dhe bulizmit në shkollë? Pyetja është: çfarë bëjmë ne për ata?

Milva Ekonomi - Nuk jam dakord me ju për këtë gjë, sepse të kesh kujdes për fëmijën, nuk do të thotë jesh prind ose gjysh.

Altin Hazizaj – Pa diskutim, unë nuk jam as prind dhe as gjysh.

Milva Ekonomi – E ke ndjesinë e fortë, sepse mendon se ata janë e ardhmja e vendit dhe mendon se duhet të rriten në mënyrë të shëndetshme, qoftë ushqimore, qoftë emocionale.

Altin Hazizaj – Kjo është përgjegjësia jonë.

Milva Ekonomi – Kjo është e rëndësishme. Besoj se për të gjithë anëtarët e këtij komisioni, dhe ata që nuk janë, kjo është përgjegjësia më e madhe që kanë dhe kështu e ndiejnë.

Altin Hazizaj – Pa diskutim, por në momentin që një prind, një gjysh, një gjyshe shkon dhe ankohet për dhunë në shkollë, sot nuk ka një mekanizëm që ajo ankesë të trajtohet në mënyrën më të mirë të mundshme dhe të zgjidhet, prandaj pyeta se kush ka një fëmijë.

Nëse unë dua të ankojem, mund ta bëj nga pjesa administrative, sepse nuk kam fëmijë vetë dhe të sjell rastin e fëmijës tim, por eksperiencia na tregon se shkollat tona nuk janë të përgatitura për të mbrojtur fëmijët nga dhuna. Pavarësisht se ka nisma dhe shumë projekte që janë realizuar, ata nuk janë fokusuar tek esenca e problemit, te ndërtimi i mekanizmit të raportimit dhe parandalimit të dhunës në shkollë.

Unë dua të ndalem në një aspekt më specifik, i cili ka të bëjë me dhunën ndaj fëmijëve në internet, *online*. Është tepër specifike, por nga të gjitha raportimet dhe bisedat me fëmijët, neve na rezulton se shumica e grabitqarëve seksualë po i kërkojnë viktimat e tyre *online*. Pse ndodh kjo?! Sepse është më e lehtë. Sot thuajse çdo fëmijë ka një telefon celular inteligjent, ku shpeshherë ky telefon është jashtë kontrollit të prindërve dhe automatikisht, që është edhe pjesa më e hidhur, fëmijët kanë tendencën të shkojnë të takojnë njerëz të panjohur. Pra, kjo do të thotë se kemi disa rreziqe, ku fëmijët janë vetë aktorë. Në këtë aspekt, pyetja që shtrohet është: çfarë bën shkolla për t'i ndërgjegjësuar fëmijët? Këtu kam disa shqetësime, që unë dua t'i ndaj para komisionit.

Së pari, që Linda dhe Mirgiti me të drejtë i përmenden, janë shqetësimet globale, pra mënyra se si trajtohet dhuna në shkollë dhe çfarë mangësish ka. Kur vijmë te çështja e internetit

të sigurt, në fakt, shkollat janë totalisht të papërgatitura, sepse, së pari, nuk ka një politikë ose standard specifik të mbrojtjes së fëmijëve në shkollë dhe, së dyti, nuk ka një standard specifik për sigurinë e fëmijëve *online*.

Unë po marr me radhë të tre aktorët kryesorë për sa i përket sigurisë.

Së pari, janë mësuesit, të cilët nuk janë mjaftueshëm të trajnuar për sa u përket mjeteve dhe mënyrave se si mund të parandalohet dhuna *online*. Sot një mësuesi i kërkohet të paguajë nga rroga e tij për të marrë trajnime specifike në këtë fushë. Pra, në qoftë se organizatat joqeveritare nuk u ofrojnë këto trajnime, është e pamundur që një mësues të trajnohet. Po të shikojmë shifrat, në total janë 34 mijë mësues, nëse nuk gabohem, të cilët kanë nevojë për trajnime specifike për sigurinë *online*, të cilët nuk e kanë marrë ende këtë trajnim.

Së dyti, fëmijët janë të painformuar. Sot janë mbi 300 mijë fëmijë që ndjekin arsimin parauniversitar, duke hequr fëmijët që janë të ndërgjegjësuar nga prindërit e tyre, ku këtu ka një diskutim shumë të madh, pjesa më e madhe e fëmijëve nuk janë të ndërgjegjësuar për rreziqet që u kanosen në internet.

Së treti, shumica e prindërve nuk i dinë rreziqet dhe nuk janë të informuar mjaftueshëm. Pra, do të thotë se kemi tri palë të një problemi, të cilat thuajse janë tërësisht të painformuar se si mund të mbrohen *online*. Në këtë aspekt, ne kemi asistuar me Ministrinë e Arsimit, Ministrinë e Brendshme dhe Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për të përgatitur një plan kombëtar për sigurinë *online*, i cili përfshin të gjitha fushat sipas ministrive. Në fushën e arsimit ka nevojë që ne të kemi një plan veprimi specifik dhe nuk ka nevojë të jetë i veçantë, vetëm për internet të sigurt. Në qoftë se ne kemi një plan kombëtar për parandalimin dhe trajtimin e dhunës në shkollë të të gjitha formave, fare mirë në një ndër pjesët e këtij plani mund të jetë edhe siguria në internet, duke përfshirë këtu të tri problemet kryesore.

Ne kemi nevojë të kemi një kod sjellje për mësuesit, ku çdo mësues duhet të firmosë çdo vit këtë kod, ku i bëhen të qarta detyrat dhe përgjegjësitë që ka, duke përfshirë mosushttrimin e dhunës dhe raportimin se ku duhet një mësues të raportojë, në rastet kur përballet me dhunë të fëmijës, qoftë dhunë në familje, dhunë në internet apo dhunë nga nxënësit ose mësuesit e tjerë.

Ne kemi një rekomandim specifik, Linda e përmendi pak më parë, hapja e një programi kombëtar në të gjithë Shqipërinë për shkolla të sigurta. Shkollat në Shqipëri nuk janë të sigurta, dikush mund të vijë të të dhunojë fizikisht, dikush mund të vijë të të rrëmbejë te oborri i shkollës, dikush mund të të dhunojë brenda shkollës, që do të thotë se ne kemi interes kombëtar për t'i mbrojtur fëmijët, sepse ata janë e sotmja dhe ardhmja. E thënë troç fare, askush

nga ne nuk do që t'i prekë ndokush fëmijët me dorë. Për më tepër, dhuna në vetvete gjeneron dhunë, sepse një i rritur i dhunuar ka tendencën të dhunojë të tjerët...

E fundit çështja e buxhetit të shtetit.

Sot është koha kur të gjitha institucionet publike, përfshi edhe Ministrinë e Arsimit, unë po e ndaj këtu shqetësimin, duhej të kishin konsultuar buxhetin e tyre me shoqërinë civile, para se të kthehet në ligj dhe para se të vijë në Kuvend për shqyrtim.

Asnjë nga ministritë, asnjë nga bashkitë nuk e ka ndarë buxhetin, gjë që do të thotë se ne kemi mangësi të informacionit dhe njëkohësisht të ngritjes së këtyre programeve, në bashkëpunim edhe me Ministrinë e Arsimit, por edhe me ministritë e tjera.

Në këtë kuadër, do të kërkoja edhe ndihmën e mbështetjen tuaj, që ta bëjmë buxhetin për Ministrinë e Arsimit, por edhe për ministritë e tjera, miqësor e të përshtatshëm për fëmijët. Në qoftë se vërtet duam t'i bëjmë shkollat të sigurta, për këtë çështje duhen lekë. Në qoftë se duam t'i kthejmë shkollat në qendra të vërteta komunitare, shkollat me qendër komunitare nuk kanë buxhete të tyre. Nuk kanë buxhet. Çfarë u jep bashkia? Ku ka lekë bashkia? Pra, do të thotë se kemi mangësi në terma buxhetore dhe, padyshim, kemi nevojë t'i shikojmë këto çështje në buxhetin e ri të shtetit.

Pak a shumë, këto janë rekomandimet e mia kryesore, të cilat sigurisht, mund t'ju dërgoj edhe me shkrim.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – faleminderit!

Nuk e di si do të flasim kolegët, por unë dua të bëj disa komente. Pastaj, ju mund të bëni pyetje.

Unë e lexova me kujdes publikimin tuaj, ndaj dua t'ju përgëzoj që po e çoni këtë punë përpara.

Megjithatë, midis çështjeve që ju ngrini në publikim, si dhe të çështjeve që trajtuat sot, sipas meje ka një mospërputhje, sepse ndërkohë, ajo që vura re nga publikimi është se studimi juaj bazohet kryesisht tek të dhënat e ALO-s dhe në ALO ju keni vetëm 0,3 % të të gjithë fëmijëve që janë regjistruar në arsimin parauniversitar. I pashë të dhënat, edhe ato që keni raportuar ju, është një pjesëtim i thjeshtë, por këto nuk arrijnë të jenë dot përfaqësuese për të ngritur modelin. Sepse keni një model këtu. Keni sqaruar një gjë të NAPS-it, që nuk është shoqata shqiptare e psikologëve parauniversitarë, por ajo amerikane, gjë që nuk e keni sqaruar në tekst. Unë e kam kërkuar në internet, por nuk ka rëndësi kjo.

Gjëja tjetër është botimi mbi bulizmin në shkolla, që bën Ministria e Arsimit me Këshillin e Europës. Këto janë të dhëna që nxirren nga 144 shkolla. Janë të dhëna që edhe ju mund t'i përdorni, të dhëna që janë përdorur nëpër tekste aty-këtu. Ajo që unë vura re nga teksti, është se ju, mbi bazën e këtyre të dhënave, që sipas meje nuk janë të gjitha përfaqësuese, aplikoni një model se si duhet të zhvillohet mbrojtja e fëmijëve nga dhuna në shkollë, duke rekomanduar që të ndiqet modeli i NAPS-it.

Mirëpo, në fakt, ka shumë kohë që në Shqipëri jepen modele të tjera. Për shembull, kemi *Terre des hommes*, që ofron një model, i cili është model italian. Ndërkohë, unë besoj se të gjitha modelet që propozon shoqëria civile janë modele që duhet t'i marrë në konsideratë ministria. Ajo, pastaj, mund të nxjerrë një skemë, që të përcaktojë se cili model duhet ndjekur. Problemi i parë është: a duhet të diskutojmë me Ministrinë e Arsimit, që të marrë skemën më të përshtatshme.

Gjëja e dytë që doja të thosha, është se falë jush, edhe ligji “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve” ka ardhur në fazën ku është. Më shumë ka qenë presioni juaj për të pasur një ligj. Unë mendoj se ligji është një arritje e mirë.

Gjëja e tretë e rëndësishme nuk është vetëm falë jush, por edhe falë shumë faktorëve të tjerë, për të cilën keni një meritë të vogël, sepse kryesisht është bërë nga profesionistët, është se më në fund ne kemi “Urdhrin e Psikologut”. Pra, nuk ka më psikolog që del pa licencë të marrë nga Urdhri. Kjo është gjë e mirë për të kuptuar edhe cilësinë e psikologut që do të shkojë në shkollë. Ka disa situata në të cilat, botimi që ju keni tani duhet përditësuar. Prandaj, unë them se gjetjet që ju keni në botim, siç e tha edhe zoti Vataj, janë disi të vjetëruara në krahasim me ato që kanë ndodhur tani. Çfarë ka ndodhur tani? Ju e dini se ka dalë një urdhëresë, sipas së cilës nxënësit në shkollat e arsimit parauniversitar dhe mësuesit nuk i përdorin më celularët. Është hequr e drejta e përdorimit të celularëve gjatë orarit mësimor, gjë që përbën një hap tjetër përpara.

Ju e dini se në shkolla është shtuar siguria, duke e çuar në 150 numrin e policëve të sigurisë. Mbasi u pilotuan 150 shkolla, u trajnuan 150 policë, të cilët e bëjnë sigurimin ndryshe nga një oficer sigurie, sepse trajtojnë rastet e bulizmit, të kanalit të trafikut të drogave, rrahjeve, grindjeve që mund të ndodhin mes nxënësve, të cilat pastaj i adresojnë.

Ju e dini se po bëhet gati edhe sistemi i referimit, që ligji “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve” mund ta kalojë një rast nga psikologu te policia. Mekanizmi i referuar me definicion po ndërtohet, nuk është ende gati.

Tani kam një tjetër gjë të rëndësishme, që doja të sillja në vëmendje. Ju folët për rastin e sigurisë në internet ose dhunën që ushtrohet në internet. Ky është një fenomen i ri edhe në botë, jo vetëm në Shqipëri. Ju përmendët tri situata, vendosët tri kondita, që kjo ishte e panjohur në Shqipëri. Duke qenë diçka e panjohur, edhe risku nga fenomeni është akoma i pamatshëm. Ne nuk e dimë se deri në ç'masë e kemi, por ama duhet të bëhemi gati për këtë gjë.

Unë mendoj se, në të vërtetë, ajo që po ndodh në shkollat shqiptare është që po shkohet drejt cilësisë mësimore, kjo e fundit të jep shumë më pak kohë që të merresh me gjërat që nuk janë mësimore. Po shkohet më shumë drejt sportit, që ta bën trupin më të fortë dhe të shëndetshëm, dhe është më mirë për fëmijët për të treguar të gjithë energjinë që kanë në një fushë tjetër.

Elementi i dhunës është një element, i cili në një lloj mënyre falë presionit tuaj, por falë edhe kujdesit, po ngushtohet. Unë nuk mendoj më se shkolla shqiptare është e pasigurt. Nuk jam dakord me deklaratën tuaj se shkolla është vend i pasigurt. Mos harroni që fushata “Stop dhunës” në vitin 2015-2016 ishte një fushatë ku morët pjesë edhe ju dhe ka lënë një pasojë të mirë. Nuk mund të ketë fushatë mbarëkombëtare, që nuk lë pasojë të mirë. E rëndësishme është që të përsëritet. Ajo duhet të vazhdojë, duhet të jetë prezente, por nuk e besoj se nuk keni qenë të kënaqur me atë që bëttë. Unë besoj në të kundërtën. Kjo është e rëndësishme. Unë kështu mendoj.

Një tjetër gjë e rëndësishme që dua të them, tërheqja e vëmendjes nga ana juaj për ne, për ekzekutivin për buxhetin e shtetit. E para, duhet të ketë konsultim dhe jam shumë dakord me ju. Ne do të ngremë zërin tonë që për buxhetin të ketë konsultim.

Ndërsa, lidhur me atë që buxheti duhet të jetë dashamirës ndaj fëmijëve, një buxhet që ta vendosë fëmijën në qendër të vëmendjes, kam përshtypjen se edhe ata që hartojnë buxhetin, kanë nevojë për pak trajnim. Ju të gjithë keni qenë prezentë kur ne bëmë buxhetin me bazë gjinore, i cili ishte një gjë që nuk e njihnin strukturat e hartimit të tij dhe u desh pak kohë të kuptohej pse një buxhet është miqësor me gjininë. Tani do të duhet përsëri një lloj trajnimi që buxheti të bëhet miqësor me fëmijët. Kjo besoj se do të jetë beteja jonë e përbashkët, nuk mund të jetë vetëm te ju, vetëm te ne, por së bashku.

Lidhur me të rejat që po ndodhin në sistemin arsimor, që ndoshta ju i keni dëgjuar, ju e dini që është hapur shkolla e drejtorëve, që është një institucion, i cili është krijuar dhe ende nuk ka një produkt të parë. Produkti i parë i shkollës së drejtorëve ka qenë bërja e një testimi paraprak për të kuptuar nivelin e dijeve të drejtuesve. Ju e keni parë që ministria i ka ndarë të dhënat dhe ato nuk kanë qenë të kënaqshme. Kjo ishte një nga arsyet që shkolla e

drejtorëve tani po vjen si një realitet në vend, që të ngrejë një numër drejtorësh dhe nëndrejtorësh të aftë për të qenë drejtues të vërtetë të institucioneve arsimore. Ndoshta këtu duhet të keni edhe ju një lloj vëmendjeje për të gjithë paketën e frenimit të dhunës ndaj fëmijëve.

Një tjetër gjë e rëndësishme është se ka edhe një strukturë të riorganizuar, që është ajo e shërbimeve arsimore, e cila do të vendosë në qendër të vëmendjes, pikërisht kurrikulën me nxëniet për dijet dhe për jetën. Unë besoj se edhe këtu ka një vend për të vendosur disa ura komunikimi me Qendrën e Shërbimeve Arsimore për kompetencat e nxënësve.

Një gjë tjetër e rëndësishme është vlerësimi që u bëhet nxënësve. Tani nuk ka një vlerësim individual vetëm nga mësuesi, ka një vlerësim që është më kompleks, ku sjellja e mirë është një vlerësim për nxënësin. Ndoshta kjo duhet të jetë një fushë tjetër bashkëpunimi. Unë do t'ju këshilloja shumë miqësisht, duke e parë situatën në këtë pozicion, që ndoshta trajnimet që do të vazhdoni të bëni në shkolla, përpara se të rimerren nga ju, të ketë mundësi që të ketë një diskutim me Ministrinë e Arsimit. Ju e bëni detyrën e trajnimit, por ta bëni të fokusuar dhe në bashkëpunim me ministrinë, ku në këtë rast jeni një organizatë shumë ndihmëse e sistemit arsimor në Shqipëri.

Unë vura re këto gjëra, lexova edhe të rejat e fundit që kanë ndodhur në shërbimin për nxënësit në sistemin e arsimit parauniversitar në Shqipëri dhe thashë t'i ndajmë. Do t'ju rekomandoja fort që këto studime që bëni të kenë periodicitetin e ndodhjes, të jenë një herë në disa kohë, ju e dini se si është më mirë periodiciteti, por ndoshta 3-5 vjet do të ishte shumë mire, që t'i kishim vazhdimisht, sepse shikojmë se si po shkohet drejt përmirësimit të këtij shërbimi. Të mos harrojmë se fenomenet janë të reja ose relativisht të reja në të gjithë botën dhe Shqipëria nuk mund të shmanget nga padija nga këto fenomene, sepse nuk mund të jetë në një trend tjetër. Ju faleminderit shumë!

Mendoj se duhet të vazhdojmë kështu: do të dëgjojmë edhe pyetje nga ju, kolegë deputetë, pastaj do t'ia jepja përsëri fjalën përfaqësuesve të shoqërisë civile, sepse kanë nevojë edhe ata të bëjnë disa ndërhyrje të tjera në Raport.

Po, zoti Çela.

Bujar Çela - Përsëritja e ftuarit për shpjegimin shumë të mirë nga ana teorike. Pa bërë vërejtjet e përsëritura nga ana juaj, mendoj se me shpjegimin e 3 referuesve, ndërhyrjen tuaj shumë të gjatë, por shumë të saktë, problemet kanë dalë nga të gjitha pyetjet. Unë kisha disa pyetje për t'u bërë të ftuarave, por u sqaruan nga ju. Pra, mendoj se mund t'ua kalojmë fjalën përsëri prezantuesve, që të jemi më të qartë në këtë sallë.

Milva Ekonomi - Do të bëjë një pyetje Ismeti.

Ismet Beqiraj - Përshëndetje!

Raporti që keni paraqitur mbi dhunën ndaj fëmijëve në shkolla është tepër interesant. E mbështes edhe ligjëratën e koleges Ekonomi, sigurisht edhe atë informacion që na dhatë ju, por unë kam një dy pyetje.

Pashë rekomandimet tuaja dhe vura re se ju kërkoni vetëm ngritjen dhe fuqizimin e institucioneve përkatëse për parandalimin e dhunës ndaj fëmijëve. Ju na bëtë pyetjen “a keni fëmijë”. Sigurisht që kemi fëmijë në shkolla dhe ky është një shqetësim shumë i madh i shtresave të ndryshme ekonomike dhe sociale. Po i marrim gjërat konkretisht. Njëri shkon me 200 lekë të reja në xhep, njëri shkon me 5 mijë lekë të reja në xhep, tjetri fshin ballin me 500 euro. Si mendoni ju, meqenëse jeni marrë me shumë studime në këtë fushë, që vetëm ky disnivel ekonomik të fëmijët e nivelit parauniversitar nxit në mënyrë të shfrenuar bulizmin, dhunën psikologjike, inferioritetin, pasigurinë e shumë gjëra? Si mendoni të zgjidhet kjo?

E dyta, nga studimi juaj, a mendoni se një nga kështjellat dhe foletë e edukimit, që është familja, e cila në këtë tranzicion të gjatë ka pësuar një goditje dhe është drejt shpërbërjes, me masat qeveritare që janë marrë kohët e fundit po fuqizohet dhe reformat janë për t’u përshëndetur? Ato u japin më shumë kohë drejtuesve të edukimit arsimor dhe fëmijëve që të rrinë në institucione të edukimit dhe sidomos këto të viteve të fundit, po ky është një fenomen. Nga ana tjetër, këto që po them i kam me fakte konkrete, një faktor i bulizmit ose dhunës është vetëm në kufijtë e nxënësve parauniversitarë apo edhe tek ata universitarë dhe cili është faktor? Pedagogët, mësuesit, që vetëm për të marrë bursat dhe benefitet që jep bashkia etiketojnë vetëm 5 nxënës dhe i nxjerrin të tërë me 10-a dhe të nxisin tek të tjerët...

Ne e dime, se kemi qenë vetë fëmijë dhe një fëmijë që mësonte të gjithë e quanin “peshkop”, ndërsa sot sidomos ky kontingjent, pra nxënësit apo studentet ekselentë, ndihen shumë të rrezikuar nga kjo trysni. Ju si mendoni se mund të zgjidhet kjo?

Milva Ekonomi – Urdhëroni, Almira për të bërë pyetje!

Almira Xhembulla - Faleminderit përfaqësuesve për punën që bëjnë për identifikimin, monitorimin dhe raportimin e situatës, e cila lidhet me parandalimin e çdo lloji dhune ndaj fëmijëve në sistemin arsimor parauniversitar!

Duke u nisur edhe nga ndërhyrja që bëri drejtuesja e komisionit, e cila ishte shumë në linjë me atë çka ne e mendojmë dhe e gjykojmë se si po e adresojmë, në fakt, këtë fenomen, lidhur edhe me politikat që po ndërmerret Ministria e Arsimit, do të doja të ndalesha vetëm në dy momente që lidhen me punën tuaj, duke qenë se merreni kryesisht edhe me këtë, duke

hartuar raporte të cilat janë shumë të detajuara, është një punë skrupuloze që bëhet nga organizatat, por sigurisht është mirë që këto raporte të jenë të përditësuara në momentin kur sillen për diskutim në komisione.

Duke qenë se ju përmendët edhe rritjen e numrit të psikologëve, unë do të doja të ndalem pak edhe te rritja e numrit të mësuesve ndihmës në shkolla, sepse kam përshtypjen se një ndër fenomenet e bulizmit apo mospranimi të fëmijëve me aftësi ndryshe është edhe mënyra se si ata qasen në sistemin arsimor, kështu që rritja e numrit të mësuesve ndihmës është, pa dyshim, një nismë shumë e mirë e Ministrisë së Arsimit.

Ju i jeni referuar në raport edhe objektivave që lidhen me zhvillimin e ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Patjetër, prandaj unë gjithmonë e shikoj punën në ekip. Duke qenë se ju u shprehët se vazhdimisht keni qenë partnerë me ministrinë në nisma të ndryshme, por edhe Milva e theksoi, ne të gjithë e shikojmë këtë si një gjë të përbashkët kundrejt fenomenit. Nuk duhet ta shikojmë vetëm ne, ju apo qeveria, por jemi të gjithë bashkë për një objektiv, që duam ta parandalojmë sa të mundemi, sepse është një fenomen mbarëbotëror dhe e dimë se është ekzistent. Gjithashtu, lidhur me linjën e këshillimit, dua të them se rastet e dhunës variojnë edhe në aspekte të tjera. Për shembull, zonat urbane me zonat rurale ose Tirana me zonat periferike, siç është Dibra, zona që unë përfaqësoj, varen nga kriteri gjinor në këtë aspekt, sepse ka më shumë vajza apo djem të diskriminuar. Këto dy kritere do të doja edhe njëherë t'i risjellim në vëmendje.

Për sa i përket nismës, qoftë me punonjësit e shtuar të sigurisë në shkolla, qoftë me mësuesit ndihmës, qoftë edhe me rritjen e numrit të psikologëve, mendoj se është një politikë që iu vjen shumë në ndihmë parandalimit të rasteve. Unë e lexova me vëmendje raportin, por dua të rikthej edhe njëherë në vëmendje rolin e prindërve. Kam vënë re, nga vizitat që bëjmë tani në shkolla, se bordet e prindërve dhe organizmat që përfaqësojnë prindërit në shkolla janë shumë aktive. Kjo ndodh në disa shkolla, sidomos aty ku është aplikuar shkolla si qendër komunitare. Unë mendoj se duhet ta rritë shikimin në këtë gjë, sepse është shumë e rëndësishme. Besoj se nuk bëhen gjërat vetëm me politika të mira apo me rritjen e numrit të punonjësve socialë/psikologë, por, siç e thamë edhe në këtë rast, është një reformë e përbashkët që duhet ta ndërmarrim, kështu edhe kjo duhet risjellë në vëmendje. Për të tjerat ju falënderoj dhe besoj se ishte një mundësi shumë e mirë jona për të parë se çfarë po bëhet mirë, por, sigurisht, për të reflektuar edhe aty ku ne mund të ndërhyjmë. E vlerësoj shumë edhe komentin që lidhet me konsultimin për sa i përket buxhetit, sidomos buxhetit faktik për 2018-en.

Faleminderit, drejtueses së seancës!

Faleminderit të gjithëve ju për informacionin!

Shpresoj të kemi dëgjesa të tjera, duke qenë se siguria e fëmijëve është pa diskutim në interesin e të gjithëve ne, si prindër, si qytetarë apo si përfaqësues të qytetarëve të Republikës së Shqipërisë!

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Faleminderit, zonja Almira!

A ka dikush tjetër ndonjë pyetje apo t’ua japim fjalën përfaqësuesve?

Fjala është sërish për ju.

Altin Hazizaj – Unë kam disa komente të shkurtra.

Së pari, po nisem nga baza e të dhënave. Domethënë, ju jeni vetë statisticiene dhe provimin e fitoni ju, jo unë, por ajo që dua të them është: a ju ka ardhur ndonjëherë ndonjë raport nga Ministria e Arsimit për dhunën në shkollë?

Milva Ekonomi – Unë kam marrë raportin për bulizmin, që ka bërë Ministria e Arsimit së bashku me Këshillin e Europës.

Altin Hazizaj – Për të kuptuar pse ne po kërkojmë merkatizëm kombëtar për parandalimin dhe trajtimin e dhunës në shkollë është shumë e thjeshtë. Ministria nuk mbledh të dhëna për sa i përket dhunës në shkollë, sepse po të marrësh të gjithë *data base*-t statistikore të Ministrisë së Arsimit, i gjen të gjitha të dhënat e mundshme se sa fëmijë të minoriteteve, fëmijë rom, fëmijë egjiptianë, fëmijë me aftësi të kufizuar janë në arsimin parauniversitar, në kopshte e të tjerë, por nuk ka asnjë të dhënë zyrtare se sa raste, nuk po them përqindje, të raportuara ka brenda sistemit arsimor parauniversitar. Kjo ndodh sepse nuk ka një sistem, i cili e trajton ankesën, e regjistron ankesën, e zgjidh ankesën dhe, njëkohësisht, përgatit një raport në bazë të shkollës, në bazë të DAR-it, duke thënë, për shembull, në DAR-in e Tiranës ka 100 raste të dhunës në shkollë, ndër të cilat kaq janë bulizëm për këtë arsye. Flasim për të dhënat statistikore të mirëfillta të rasteve.

Janë bërë dy studime bazë, të cilat ne i kemi përfshirë te raporti ynë, është studimi i vitit 2010 i *Save the Children* për dhunën në shkollë, që thotë se 1 në 2 fëmijë në shkollë janë viktimë të keqtrajtimit fizik, por ky është një studim i vjetër, sepse kanë kaluar 8 vjet, si dhe janë të dhënat e Këshillit të Europës dhe Ministrisë së Arsimit për bulizmin. Kjo është e dhëna bazë e dokumentur dhe këto janë statistikat. Nga ana tjetër, ne kemi të dhënat alternative, që janë raporte të mirëfillta të “Alo 116”. Pra, kjo do të thotë se “baza e plotë”, sepse nuk është e

plotë, është marrë në konsideratë në raport, duke ngritur shqetësimin, prandaj edhe neve kërkojmë mekanizmin. Duke pasur një mekanizëm, i cili është i ndërtuar mbi bazën personale...

Milva Ekonomi - A mund t'ju ndërpres vetëm një minutë, sepse kam përshtypjen se më keqkuptuat? Unë ju thashë se rekomandimet që keni bërë ju në raport lidhur me skemën më të re të mekanizmit të referimit të dhunës, janë të pambështetura në të dhëna.

Altin Hazizaj – Po, sepse nuk ka.

Milva Ekonomi – Ti bën një raportim për një model dhe mendon se me këto të dhëna, modeli që do të ndjekësh është ky, ndërkohë të dhënat nuk të çojnë dot te modeli. Prandaj bëra sqarimin. Unë hyra në internet, pashë çfarë modeli kishte *Terre des hommes* dhe pashë që për Shqipërinë kishte një model tjetër. Pra, të dhënat nuk të çojnë drejt një modeli, prandaj duhet folur me ministrinë që të përcaktojmë se cili do të jetë modeli më i mirë që do të ndjekim.

Altin Hazizaj – Kjo vlen. Ne kemi parë tri modele. Nëse më pyet mua si ekspert, unë do të thosha që më pëlqen modeli irlandez. Pse? Sepse më duket shumë european krahasuar me atë amerikan apo me ndonjë sistem tjetër. Kjo është çështje vendimtare për ministrinë. Unë mendoj se shoqëria civile nuk ka për detyrë të tregojë modelin, pra zgjedhjen do ta bëjë ministria. Ne kemi për detyrë të propozojmë disa modele që janë të përshtatshme. Edhe modeli amerikan, edhe ai irlandez janë shumë të mirë, ndërsa modeli britanik vlen për Shqipërinë, por nuk kemi të njëjtin sistem të mbrojtjes sociale dhe ka pak problem. Nëse biem dakord, kërkesa është: na duhet një sistem kombëtar i adresimit të çështjes, pra i mekanizmit kombëtar, atëherë çështja e modelit është çështje praktike. Ne do të ofrojmë një model, besoj se edhe ministria mund të sjellë modelin e vet dhe organizatat me modelin e tyre. Përse them se shkollat janë të pasigurta? Unë jam në kontakt me fëmijët dhe me adoleshentët pothuajse çdo ditë dhe ka një mospërputhje të asaj çfarë themi ne të rriturit dhe çfarë thonë fëmijët. Po sjell dy raste shumë shkurt: një mësuese në një gjimnaz të Tiranës e cila ngacmon seksualisht fëmijët dhe i bën të ndihen seksualisht të turpëruar, ka probleme personale dhe me personalitetin. Pasi ne, prindërit dhe drejtorja e shkollës, ankohemi, mësuesja transferohet nga gjimnazi “A” në atë “B”. Kjo nuk është siguria e fëmijëve. Zonja në fjalë do të ushtrojë të njëjtën dhunë seksuale ndaj fëmijëve të tjerë në gjimnazin tjetër. A është ajo shkollë e sigurt? Jo nuk është. Në momentin që turpërojmë adoleshentët tanë për aspekte seksuale, do të thotë që atyre nuk u mësojmë sjellje seksuale të shëndetshme dhe, e dyta, turpërimi nuk është qëllimi i shkollës, dinjiteti dhe respekti janë qëllimi i shkollës.

Rasti tjetër është në është Dibër, ku 25 vajza, nga klasa e 6-të deri në klasën e 9-të, ndjehen viktima të paragykimit dhe diskriminimit thjesht sepse janë vajza. Ky diskriminim,

fatkeqësisht, fillonte nga familja dhe vazhdonte edhe në shkollë. Shkolla nuk arrin t'ua japë dot asnjë lloj zgjidhjeje dhe perspektive vajzave, sepse ato duhej të vazhdonin shkollën e lartë dhe pse do të shkonin në shkollë të mesme. Një shkollë që nuk u ofron një perspektivë të barabartë dhe të sigurt vajzave, për mua nuk është shkollë e sigurt.

Kolegët mund të kenë edhe çështje të tjera, por, meqë po diskutojmë, po i kthehem pak çështjes së pabarazisë në shkollë. Po, ka pabarazi në shkollë. Ka modele të mira që janë ndjekur dhe ndjekin në të gjithë botën.

E para, ka programe të mbrojtjes sociale në shkollë. Për nxënësit që nuk janë në gjendje të mirë ekonomike, ne kemi kërkuar prej kohësh që në çdo shkollë të ketë menca, të marrin një vakt falas dhe për ata që kanë para, ta blejnë ushqimin, pra u garanton atyre që janë të varfër një vakt falas. Kjo është më e pakta që shteti bën për mbijetesën e fëmijëve.

E dyta, uniformat, shumë shkolla e kanë futur uniformën për të eliminuar pabarazitë, sepse njëri mund të vijë i veshur firmato dhe fëmijët e tjerë vishen normal. Veshja e uniformës shmang pabarazinë. Se çfarë ndodh jashtë mureve të shkollës është e drejta e fëmijës dhe e drejta e prindit; në shkollë uniforma u jep mundësi fëmijëve të duken të barabartë.

E treta, familja në Shqipëri shpenzon për arsimin e fëmijës. Nga viti 2016 në vitin 2018 është dyfishuar shuma që familjet shpenzojnë për arsimimin e fëmijëve, nga 2.8 ka vajtur në 4.3. Kjo tregon që familja shqiptare investon për arsimimin. Ne duhet të gjejmë mënyra për ta fuqizuar familjen që të investojë akoma më shumë për arsimimin e fëmijëve.

Për sa i përket bulizmit, thuajse në të gjithë Europën edhe në Amerikë është kaluar në programin “shkolla të sigurta”. Kjo do të thotë që fëmijët janë të gjithë të ndryshëm dhe shkolla ka për detyrë të menaxhojë këtë diversitet dhe ta fuqizojë. Ne nuk duam të kemi njerëz njësoj, sepse nuk jemi as në nazizëm dhe as në komunizëm që njeriu duhet të jetë njësoj. Ne jemi të ndryshëm dhe kjo na bën më të mirë.

Për sa i përket modelit, faktikisht, ashtu siç thoni edhe ju, të dhënat janë shumë të rëndësishme, por ne jemi bazuar kryesisht te volumi i rasteve që kemi trajtuar. Nuk janë pak, janë diku te 850 raste. Jemi bazuar kryesisht te vlerësimi i secilit prej këtyre rasteve. Pra, ai model që ne kemi propozuar, është i bazuar në profilizimin e secilit rast, bazuar mbi nevojat që ka sistemi, mbi mangësitë dhe, sigurisht, duke parë të gjithë aktorët e mundshëm. Është një model që ne kemi menduar, kemi qenë një grup ekspertësh që kemi punuar mbi atë raport, se u përshtatet të gjitha nevojave që kemi trajtuar, si Linjë Kombëtare Këshillimi për Fëmijë, por duke u bazuar edhe tek të dhënat e partnerëve të ndryshëm për dhunën.

Për sa u përket risive, faktikisht, shumica e risive dhe e masave kanë ardhur vitet e fundit ose, më saktë, këtë shtator, pra policimi në shkolla dhe të gjitha masat që ju cituat, janë të këtij shtatori. Pra, nuk jemi shumë larg, ka vetëm një muaj. Raporti është përgatitur për vitin 2017 dhe për pjesën e parë të 2018-s. Kështu që këtu ishte pjesa e kontradiktës, për ta sqaruar. Gjithashtu, është ngritur Urdhri i Psikologut, por Urdhri i Punonjësit Social akoma nuk ka marrë udhë. Kështu që shërbimi psikosocial në shkolla nuk ofrohet vetëm nga psikologët, por edhe nga punonjësit socialë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk ka filluar akoma. Të premten ishte diskutimi i fundit, por duhet pak kohë të ngrihet. Specifikë e Linjës Kombëtare të Këshillimit për Fëmijë, pra Alo-116-ta, është që të gjitha të dhënat që raportohen janë me vetëdeklarim të fëmijëve dhe nuk janë me pyetësor të plotësuar nga fëmijët, ku për një rast dhune, për një rast të shkeljes së të drejtave të fëmijëve në sistemin arsimor, një fëmijë mund të marrë telefonin, të formojë numrin 116/111 dhe të raportojë në kohë reale, si dhe të flasë me personin që është i përgatitur për të trajtuar atë rast.

Për sa i përket bulizmit, faktikisht, nga rastet që kemi trajtuar, disniveli ekonomik është një nga faktorët që ndikon që fëmijët të bulohen dhe të jenë viktima të bulizmit. Pra, për pyetjen “nëse është disniveli ekonomik një nga arsyet që fëmijët sot janë viktima të bulizmit”, përgjigjja është po. Një ndër arsyet madhore që fëmijët raportojnë bulizëm, duke u bazuar te Linja e Këshillimit për Fëmijë, por edhe duke analizuar, sepse unë vij nga një profil social, është disniveli ekonomik, bashkë me përkatësinë etnike dhe origjinën.

Shpërndarja e bulizmit në sistemin arsimor është në të gjitha hallkat. Ka raste bulizmi dhe incidente duke filluar nga shkolla fillore, deri në sistemin universitar.

Për sa i përket shtrirjes dhe zonave urbane, si dhe pyetjes që bëri zonja për shpërndarjen në aspektin gjeografik, zonat e mëdha urbane janë raportueset më të shpeshta të bulizmit, pra kryesisht janë në Tiranë, Durrës, Elbasan, Shkodër. Kemi pasur raste bulizmi nga e gjithë Shqipëria, por volumi më i madh i rasteve vjen nga zonat e mëdha urbane. Këtu bulizmi është më evident për t’u raportuar. Djemtë raportojnë më shumë, krahasuar me vajzat. Shpërndarja e këtij fenomeni është e evidentuar pothuajse në të gjithë Shqipërinë. Në zonat më të mëdha urbane është më e shpeshtë. Kaq kisha. Faleminderit!

Milva Ekonomi – Para se të fillonte kjo seancë, ne i bëmë një ftesë Ministrisë së Arsimit, për të sjellë dikë që të na tregonte se ç’po bëjnë ata më shumë, si dhe për ta koordinuar më mirë veprimtarinë mes palëve në këtë rast.

Zonja Shqiponja Lamçe është ulur mbas jush dhe mbase mund të na sqarojë diçka në lidhje me botimet vjetore që duhen bërë për dhunën, si bëhen ato, a mbledhen ose jo të dhënat dhe pse. Kemi nevojë t'i dëgjojmë këto, që t'i jepnim një mundësi më shumë shoqërisë civile të bashkëpunojë, në qoftë se duhet, për të bërë pyetëtorin apo për të rregulluar diçka me ju.

Shqiponja Lamçe – Faleminderit!

Nuk i heq asnjë presje gjërave që ju prezantuat për analizën e raportit, i bëtë në mënyrën më të mirë të mundshme, por desha të ndalem në disa pika, ku nuk jam dakord.

Së pari, plani kombëtar “Stop dhunës në...”

Milva Ekonomi - Do t'ju thosha vetëm një gjë, këto 3 shoqata punojnë me zemër dhe me shumë...

Shqiponja Lamçe – E di, kemi shumë vite që bashkëpunojmë...

Milva Ekonomi -...E kanë me dëshirë shumë të madh këtë punë që bëjnë dhe ndiejnë përgjegjësi.

Shqiponja Lamçe – U jam mirënjohëse. Altini e përmendi, edhe më herët ne kemi bashkëpunuar në grupe pune të përbashkëta, njihemi prej vitesh. Për sa i takon kësaj pike, unë i falënderoj, jo vetëm këta, por edhe pjesëtarët e tjerë të organizatave që kanë qenë krah nesh.

Gjithashtu, doja t'ju thosha se plani kombëtar “Stop dhunës në shkollë”, që filloi në vitin 2016, vazhdon ende. Në atë kohë u bë lançimi i tij dhe të gjitha organizatat dhanë kontributin e tyre, por ne nuk e lamë vetëm me atë vit, por kjo vazhdon çdo vit në të gjitha shkollat e Republikës, që nga shkollat 9-vjeçare deri në shkollat e mesme. Në çdo udhëzim në fillim të çdo viti shkollor ne japim orientimin pikërisht për planin “Stop dhunës në shkollë”.

Diçka tjetër që doja t'ju thosha është fakti se ne kemi një model të evidentimit, të raportimit dhe të trajtimit të rasteve të dhunës në institucionet shkollore, modeli që përmendi zonja Milva, të cilin e ka futur fillimisht Erdezom-i. Ky raportim ndodh te mësuesi kujdestar, te psikologu, drejtori dhe më pas kalon në Drejtorinë Arsimore dhe në njësinë e mbrojtjes së fëmijëve. Nëse do të shihnim udhëzuesin që është për këtë punë, aty parashikohet që nga rastet, të cilat kanë një kohëzgjatje dhe mund të presin, deri te rastet emergjente që duhen zgjidhur brenda 24 orëve.

Sa u takon të dhënave, duke filluar që nga viti 2014, ne kemi të dhëna për rastet e evidentuara dhe të trajtuara të dhunës në institucionet shkollore, duke filluar që nga kopshtet deri te shkollat e mesme. Konkretisht, kam raportin e fundit, ku mund t'ju jap me shifra rastet për vitin 2017-2018, të ndara dhe të specifikuara këto sipas një manuali që Ministria e

Shëndetësisë ka bërë para 4 vjetësh, në dhunë fizike, emocionale, seksuale dhe neglizhim. Këto janë të ndara në dy grupe, nxënës-nxënës dhe mësues-nxënës.

Për vitin 2017-2018 kanë qenë 2342 raste të evidentuara dhe trajtuara deri në fund, pra të dokumentuara. Sigurisht, mund të ketë raste të tjera të padenoncuar, të patrajtuara, por mendoj se kjo është një arritje, pasi ne kemi mundur t'i trajtojmë këtë numër rastesh. Në krahasim me një vit më parë kemi pasur 1805 raste. Unë shoh gjithmonë sensin pozitiv, pra rritja e numrit të rasteve të evidentuara dhe të trajtuara tregon një sensibilizim dhe funksionimin e mekanizmave, sepse nëse mekanizmat nuk do të funksiononin nuk do të kishim rritje të rasteve të evidentuara dhe të trajtuara.

Ndoshta janë për t'u parë raportet, të cilat ne i kemi që nga viti 2014, si dhe të dhënat që i marrim në nivel shkolle, të publikohen në faqen tonë të internetit, gjë që nuk është bërë deri tani, por kryesorja është që ne i disponojmë. Nëse dikush do të na i kërkonte, patjetër që do t'ia vinim në dispozicion.

Pra, që nga viti 2014 ne kemi 4 raporte.

Milva Ekonomi – Unë do t'ju këshilloja miqësisht, por edhe institucionalisht që ato raporte të vihen në *web*. Ndërkohë, teksa po shihja botimin statistikor të të dhënave tuaja, viti 2015-2016 ishte i fundit, ndërsa vitet 2016-2017 dhe 2017-2018 nuk ishin.

Shqiponja Lamçe – Viti 2016-2017 është në përfundim dhe brenda muajit dhjetor do të dalë.

Milva Ekonomi – Pra, është ndër gjërat që duhet pasur parasysh, vendosja e raporteve në internet, sepse për sa kohë mblidhen të dhënat dhe janë një dokument publik, nuk ka nevojë të jetë vetëm në *hard-copy*, por duhet të jenë edhe në *website*, sepse ndihmon më shumë. Sa i takon analizës që kanë bërë këta, po të kishin qenë të dhënat aty, orientimi për modelin do të ishte ndryshe, prandaj mendoj se këto gjëra duhen ndarë, që t'i rrimë përballë fenomenit dhe jo ta shmangim.

Zoti Ismet bëri një pyetje për kohën e shkuar, nëse në atë kohë kishte bulizëm. Në fakt, në atë kohë duhet të ketë pasur bulizëm, por ne nuk e dinim se çfarë ishte bulizmi. Ne nuk e dinim se shëndeti emocional i fëmijëve ndikonte aq shumë në shëndetin fizik, sepse sa më përpara shkon shkenca, aq më shumë duhet ta ndjekim edhe ne. Në Shqipëri më parë nuk ka pasur urdhër apo shërbim psikologu, ndërsa tani janë të gjitha mundësitë, prandaj është mirë që arritjet në këto fusha të reja të ndahen mes aktorëve. Në këtë rast do t'ju thosha diçka, sepse janë të shumta diskutimet për këtë çështje, prandaj do t'ju rekomandoja ju të treve, që jeni përfaqësues të shoqërisë civile, të vazhdoni të bëni studimin periodik. Ne do të bëjmë një letër,

duke u këshilluar me OJF-të për buxhetin, për ministritë që ne kemi në varësi si komision, Ministrinë e Arsimit dhe të Kulturës.

Gjithashtu, do t'ju rekomandoja që botimet që ju bëni, të mos jenë vetëm në *hard-copy*, por të vihen në internet *online*. Qendra e Shërbimeve Arsimore po ridimensionon rolet; mbase modeli i referimit ka nevojë për tryeza të rrumbullakëta, për ta ndjekur edhe ministria, edhe shoqëria civile. Ne të gjithë tani po kuptojmë sa punë të mirë bëni ju, sa punë e mirë bëhet në vend. Kolegët bënë pyetje që lidheshin me situatën. Ju ndatë idenë e uniformës në shkollë, por duhet të ketë fantazi. Është debat i mirë për t'u bërë edhe ky: pro ose kundër uniformës. E rëndësishme është që ky bashkëbisedim me shoqërinë civile duhet të vazhdojë, për shembull, falënderojmë ministrinë, por faleminderit edhe për presionin tuaj për heqjen e celularit.

Në të gjitha komisionet kemi anëtarët e përhershëm dhe anëtarët zëvendësues. Unë jam anëtare zëvendësuese te Komisioni i Sigurisë dhe kam pasur mundësinë të shoh nga afër se çfarë po ndodh me policimin në komunitet. Ka ndryshuar plotësisht ligji dhe kjo është pjesë e presionit që bën shoqëria civile. Policimi në komunitet ka për të ndihmuar shërbimet kundër dhunës në familje për gratë dhe fëmijët. Unë realisht shoh që reagimi ndaj dhunës është në rritje.

Faleminderit!

Ftojme shoqërinë civile të marrë pjesë në diskutimin për buxhetin dhe të shprehin mendimet e tyre.

Altin Hazizaj - Ne do të nxisim komisionin të përgatitë dhe të miratojë një rezolutë të posaçme për të drejtat e fëmijëve në shkollë, në mënyrë që ju të krijoni një bazë të monitorimit të arritjeve. Nëse ne e vendosim çështjen e dhunës, diskriminimin, përjashtimin social, pabarazinë, mendoj se do të dalë një rezolutë përmes së cilës të monitorohet puna dhe arritja e arsimit. Pra, ju vendosni disa indikatorë të matjes në këtë drejtim, përfshi edhe buxhetin.

Milva Ekonomi- Faleminderit!

Kolegë, kemi edhe dy çështje të tjera për të diskutuar, procesverbalin e mbledhjes së kaluar dhe kalendarin e kësaj jave.

A jeni dakord me procesverbalin? Dakord.

Së fundi, unë kam një ide për qëllimin që do të ketë vizita që kemi ndërmend të bëjmë në *sitet* kulturore. Ideja ime është: sa është rritur numri i turistëve dhe bashkë me këtë sa është rritur numri i të ardhurave, si e njohim ligjin e ri të trashëgimisë kulturore dhe si mund ta

shikojmë veten përfitues nga ky ligj për të ardhurat dytësore, dhe po t'i përfitojnë si kanë për t'i shpenzuar. Kjo duhet të jetë tema e vizitave, që të nxjerrim një raport. A jeni dakord kështu?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Akoma, sepse implementimi i ligjit kërkon kohë, sepse janë aktet nënligjore. I kemi dhënë 8, 6, 18 muaj kohë të ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, për ato që kanë, do ta shikojmë. I themi Gazmendit të bëjë një kërkim në ligj, në qoftë se ka akte nënligjore që duhen nxjerrë dhe t'i shikojmë.

Atëherë, shihemi të enjten.

MBYLLET MBLEDHJA